

**RREGULLORE NR. 2000/29**

UNMIK/REG/2000/29

20 maj 2000

**MBI VËNIEN E TATIMIT PAUSHALL**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të ndryshuar, të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/16, të ndryshuar, të datës 6 nëntor 1999 mbi Themelimin e Organit Qendror Fiskal dhe çështje të tjera lidhur me të,

Me qëllim të vënies së tatimit paushall,

Shpall sa vijon:

Neni 1

**PËRKUFIZIMI**

Sipas kësaj rregulloreje:

- (a) “Person” do të thotë çdo entitet ose person fizik, publik ose privat, që angazhohet në çfarëdo veprimtarie ekonomike, ligjore a joligjore me qëllim fitimi në Kosovë, duke përfshirë veçmas: personat juridikë, ndërmarrësit individualë, institucionet e përhershme dhe personat jorezidentë, që kanë të bëjnë vetëm me të ardhurat e krijuara në Kosovë.
- (b) “Tatimpagues” do të thotë çdo person i cili angazhohet në veprimtari ekonomike me qëllim të fitimit në Kosovë në çfarëdo kohe gjatë vitit kalendarik, i cili nuk merr rrogë për atë veprimtari.
- (c) “Tatimpagues i vogël” do të thotë çfarëdo tatimpaguesi (pos kompanive të sigurimit) që ka realizuar të ardhura bruto më pak se 15. 000 DM në të gjithë tremujorët e përparshëm kalendarik;
- (d) “Tatimpagues i madh” do të thotë çdo tatimpagues (pos kompanive të sigurimit), që nuk konsiderohet tatimpagues i vogël sipas këtij neni.

- (e) “Veprimtari me qëllim fitimi” do të thotë çdo veprimtari e cila fillohet për fitim apo të ardhura, duke përjashtuar ato veprimtari të regjistruara si jofitimprurëse nga UNMIK-u, ndonjë agjenci të aftë apo administratën tatimore.

## Neni 2

### **TATIMI PAUSHALL**

Tatimi paushall është pagim monetar i tatimit në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës në bazë të të ardhurave paushalle.

## Neni 3

### **BAZA E TATIMIT TË TATIMPAGUESIT**

3.1 Baza e tatimit paushall varet nga tipi dhe vendi i veprimtarisë ekonomike.

3.2 Tipi i veprimtarisë ekonomike i tatimpaguesve klasifikohet në katër kategori: Tatimpaguesit (pos kompanive të sigurimit), të cilat nuk janë cekur në ndonjërin prej kategorive, paguajnë tatimin që vlen për kategoritë e veprimtarive më të ngjashme me të cilat ata merren.

(a) Bizneset, kryerësit e shërbimeve, profesionistët dhe tregtarët. Kjo përfshin veçmas:

- i Tregtarët që tregtojnë me pakicë apo konsumatorët e fundit, veçmas prodhimet e ushqimit, veshmbathjes, artikujt e modës, butiqet, parfumet, metalet e çmueshme, stolitë, produktet farmaceutike, pajisjet, artikujt metalikë dhe mallrat shtëpiake.
- ii Bizneset që merren me prodhoimin e produkteve, duke përfshirë veçmas aluminin, tekstin, ushqimin e përpunuar, makinerinë, veglat, tjegullat, materialin ndërtimor, prodhimet e drurit dhe mobiljet.
- iii Kryerësit e shërbimeve të ndryshme afariste, duke përfshirë veçmas bankat, institucionet e tjera financiare, fotografët, sallonet e bukurisë, rrojtoret, rrobaqepësitë, automekanikët, vendparkimet, institucionet arsimore, këpucarët, autoshkollat, kafenetë dhe dhënie me qira të pajimeve apo të ndonjë pasurie tjetër, duke përfshirë këtu edhe banesat me qira.
- iv Profesionistët, duke përfshirë veçmas avokatët, noterët, ekonomistët, kontabilistët, mjekët, dentistët, farmacistët, inxhinierët, arkitektët, ekspertët e kompjuterëve dhe
- v Zejtarët, duke përfshirë veçmas bojaxhinjtë, instaluesit e ujit, elektrikistët, marangozët, muratorët, veterinarët, agronomët.

- (b) Veprimtaritë argëtuese. Kjo përfshin veçmas lokalet e biliardos, objektet për bixhoz, diskot, kinematë, teatrot dhe objektet sportive.
- (c) Veprimtaritë e transportit. Kjo përfshin veçmas transportin e udhëtarëve dhe transportin e mallrave.
- (d) Tregtarët shetitës, zejtarët dhe veprimtaritë me të ardhura të ulëta. Kjo përfshin veçmas tregtarët e rrugës, zejtarët, bujqit të cilët shesin prodhimet e tyre në treg të hapur dhe çfarëdo veprimtarie tjetër duke përfshirë ato në nenin 3.1(a), 3.1(b) dhe 3.1(c) më sipër, që prodhojnë të ardhura bruto tremujore më pak se 2.500 DM.

3.3 Vendi i veprimtarisë ekonomike klasifikohet në tri kategori. Vend i veprimtarisë ekonomike konsiderohet çfarëdo shitore, njësi e ndarë apo vend tjetër i caktuar ku zhvillohet biznesi. Tri kategoritë e vendeve janë:

Vendi A: Prishtina

Vendi B: Qyteti i Prizrenit, Gjiçilani, Peja, Gjakova, Ferizaj;

Vendi C: Të gjitha zonat e papërfshira në kategorinë A dhe B.

#### Neni 4

##### **LARTËSIA E TATIMIT**

4.1 Tatimpaguesit e vegjël. Secili taksapagues i vogël do të paguajë taksën paushalle varësisht nga tipi i veprimtarisë ekonomike dhe vendi i veprimtarisë. Tatimi i caktuar paushall tremujor është përcaktuar në shtojcën A të kësaj Rregulloreje.

4.2 Tatimpaguesit e mëdhenj. Çdo tatimpagues i madh duhet të paguajë taksën e caktuar paushalle tremujore të cekur në Aneksin A të kësaj Rregulloreje plus tre për qind (3%) të të ardhurave bruto (mbi 15.000 DM). Të ardhurat bruto për bankat dhe institucionet e tjera financiare përbëhen nga të hyrat e interesit, pagesat dhe komisionet. Të ardhurat bruto për të gjithë tatimpaguesit e tjerë të mëdhenj do të thonë shitjet bruto.

4.3 Kompanitë e sigurimit. Çdo kompani e sigurimit duhet të paguajë një tatim paushall tremujor në masën prej dhjetë për qind (10%) të mbivlerës nominale bruto.

#### Neni 5

##### **KUSHTET PËR MBAJTJEN E SHËNIMEVE**

5.1 Varësisht nga kategoria e tatimpaguesit, duhet të mbahen librat e llogarive dhe shënimet e mëposhtme për shitjet me para të gatshme, shitjet e ditës, furnizimet ditore, faturat e shitjet, faturat e doganave dhe dokumentet e tjera në lidhje me importin.

5.2 Librat dhe shënimet e saktësuara në nenin 5.1 mbahen në përputhje me udhëzimin administrativ që e lëshon Organi Qendror Fiskal në pajtim me nenin 3 (b) të Rregullores 1999/16 të UNMIK-ut, të ndryshuar.

Neni 6

#### **DEKLARATA TATIMORE DHE PAGESAT**

6.1 Tatimpaguesit e vegjël i dorëzojnë deklaratën tatimore dhe e paguajnë taksën fikse paushalle në fuqi, e cila është dhënë në tabelën e taksave në Shtojcën A, në këto data ose para këtyre datave: më 15 prill (për periudhën 1 janar deri më 31 mars); më 15 korrik (për periudhën 1 prill deri më 30 qershor); më 15 tetor (për periudhën 1 korrik deri më 30 shtator) dhe më 15 janar (për periudhën 1 tetor deri më 31 dhjetor).

6.2 Tatimpaguesit e mëdhenj e dorëzojnë deklaratën tatimore dhe e paguajnë tatimin e caktuar paushall që është dhënë në tabelën e tatimit në shtojcën A, plus tre për qind (3%) të të ardhurave të tyre tremujore bruto që tejkalon shumën prej 15.000 DM, në këto data ose para këtyre datave: më 15 prill (për periudhën 1 janar deri më 31 mars); më 15 korrik (për periudhën 1 prill deri më 30 qershor); më 15 tetor (për periudhën 1 korrik deri më 30 shtator) dhe më 15 janar (për periudhën 1 tetor deri më 31 dhjetor).

6.3 Kompanitë e sigurimit e dorëzojnë deklaratën tatimore dhe e paguajnë tatimin paushal në shumën prej dhjetë për qind (10%) të mbivlerave të tyre të përgjithshme nominale në këto data ose para këtyre datave: më 15 prill (për periudhën 1 janar deri më 31 mars); më 15 korrik (për periudhën 1 prill deri më 30 qershor); më 15 tetor (për periudhën 1 korrik deri më 30 shtator) dhe më 15 janar (për periudhën 1 tetor deri më 31 dhjetor).

6.4 Vendi i dorëzimit të deklaratave dhe procedurave tatimore për pagimin e tatimit do të saktësohet me një urdhëresë administrative të cilën e nxjerrë Organi Qendror Fiskal në përputhje me nenin 3 (b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/16, të ndryshuar.

Neni 7

#### **KONTROLLIMI I SHËNIMEVE**

Zyrtarët e tatimit në Administratën Tatimore të Organit Qendror Fiskal mund t'i kontrollojnë të gjitha shënimet dhe dëshmitë e tjera përkatëse për të vërtetuar respektimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 8

#### **DERDHJA E TË ARDHURAVE**

Të hyrat e mbledhura nga tatimi paushall depozitohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 9

**SHKELJET DHE GJOBITJET**

Çdo tatimpagues i cili bën shkelje tatimore i nënshtrohet gjobitjeve të parashtruara në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/20 të datës 12 prill 2000 mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore.

Neni 10

**ANKESAT**

Çdo tatimpagues i cili mendon se vendimi zyrtar i marrë me këtë Rregullore është i padrejtë mund të shtrojë ankesë në përputhje me procedurat e parashtruara në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/20 të datës 12 prill 2000 mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore

Neni 11  
**LIGJI NË FUQI**

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 12  
**ZBATIMI**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë urdhëresa administrative lidhur me zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 13  
**HYRJA NË FUQI**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20 maj 2000.

***Bernard Kouchner,***  
***Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm***

## SHTOJCA A

<b>LLOJI/VENDI I VEPRIMTARISË EKONOMIKE</b>	<b>VENDI A</b>	<b>VENDI B</b>	<b>VENDI C</b>
SUBJEKTET AFARISTE, OFRUESIT E SHËRBIMEVE PROFESIONALISTËT, ZEJTARËT	DEM 400	DEM 300	DEM 200
ARGËTIMI	DEM 400	DEM 300	DEM 200
TRANSPORTI	DEM 250	DEM 200	DEM 150
TREGTARËT SHËTITËS ARTIZANËT DHE VEP- - RIMTARITË E TJERA ME TË ARDHURA TË VOGLA	DEM 75	DEM 75	DEM 75